



Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo	
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE	
Wesia Org. / Org. / Org. / Org.	12-06-3590
10 09 19	

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finasije Ministry of Finance  
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo



LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	24/DSP-2019				
PËR/ZA/TO:	Për stafin e ATK-së				
CC	z. Ilir Murtezaj, Drejtor i Përgjithshëm në Administratën Tatimore				
NGA/OD/FROM:	z. Arsim Syla, Menaxher i Divizionit për Standarde Profesionale.				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për Deklarim të statusit politik të nëpunësit civil				
Nr. i zyrës:		Lokacioni:		Data:	
Br. kancelarije:	505	Kucni:	038/200-250-46	Datum:	10.09.2019
Room No.:		Extension:		Date:	

Të nderuar kolegë/e,

Siç jeni informuar tashmë nga Departamenti i Shërbimeve Juridike nga nesër me datë 11 Shtator 2019 fillon së zbatuari Ligji i ri Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik i cili e zëvendëson Ligjin e mëparshëm Nr. 03/L -149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

Me qëllim që të sigurohemi se Administrata Tatimore si pjesë e Shërbimit Civil zbaton drejt dhe në mënyrë efikase ligjet në fuqi, duke respektuar parimin e përgjithshëm të mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizimit dhe paanësisë politike si dhe me qëllim që të krijojmë standarde të larta për ruajtjen e Integritetit e Administratës Tatimore, përmes kësaj shkrese dëshiroj t'ju njoftoj për obligimet që kemi si staf i ATK-së karshi ligjit të ri, dhe njëkohësisht të kërkoj nga të gjithë zyrtarët të cilët kanë poste politike ose janë të kyçur në mënyrë aktive në parti politike që më së voni **deri me datën 16 Shtator 2019** të deklarohen me shkrim dhe të përcaktohen se a dëshirojnë të vazhdojnë punën në Administratën Tatimore apo të merren aktivisht me politikë dhe të mbajnë poste drejtuese në parti politike.

Një obligim i tillë ligjor i të punësuarit në ATK( me përjashtim të stafit teknik dhe mbështetës) për të vendosur ndërmjet pozitës që mban në Administratën Tatimore dhe postit në një pozitë drejtuese në një subjekt politik, është i sanksionuar me nenin 22 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, sipas të cilës dispozitë:

nëpunësit civilë, me përjashtim të nëpunësve të kategorisë së lartë drejtuese, mund të jenë anëtar të partive politike, por, nuk mund të jenë anëtarë të organeve drejtuese (qendrore dhe lokale) të një partie politike.

Prandaj, bazuar në këtë dispozitë ligjore, Divizioni i Standardeve Profesionale, edhe njëherë kërkon nga të gjithë zyrtarët e ATK-së që janë të emëruar apo që dëshirojnë të jenë në pozita drejtuese nëpër subjekte të ndryshme politike që të përcaktohen ndërmjet pozitës politike apo të qenurit në pozitën e nëpunësit civil, duke e paralajmëruar secilin që nëse një gjë të tillë, nuk e bëjnë vet brenda afatit të përcaktuar më sipër, atëherë, ATK-ja sipas autoritetit ligjor që ka, do të jetë e detyruar të ndërmarr veprime ligjore për të identifikuar rastet e tilla dhe më pastaj varësisht të gjeturave, Drejtori i Përgjithshëm si autoritet i vetëm në cilësi të punëdhënësit do të zbatojë dispozitat e nenit 61, paragrafit 1, nën paragrafit 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, duke liruar nga shërbimi civil gjegjësisht duke ja ndërprerë marrëdhënien e punës secilit zyrtar për te cilin konstatohet se është anëtar i organeve drejtuese në një subjekt politik.

Bashkëngjitur kësaj shkrese gjeni formularin e dizajnuar nga Divizioni i Standardeve Profesionale përkitazi me deklarimin e pozitës që zyrtari dëshiron të zgjedh, të cilin pasi ta plotësoni dhe nënshkruani së bashku me dëshmitë përkatëse e dorëzoni në Divizionin e Standardeve Profesionale, përmes postës elektronike ose drejtpërdrejtë në kopje fizike.

Ju faleminderit në Vëmendje!





Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finasije Ministry of Finance  
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo



## DEKLARATË

Unë \_\_\_\_\_, me nr. ID: \_\_\_\_\_ me pozitë të punës në ATK  
\_\_\_\_\_, deklaroj se aktualisht mbaj postin politik, në pozitën  
\_\_\_\_\_, në kuadër të subjektit politik: \_\_\_\_\_.

Në zbatim të kërkesave ligjore sipas Ligjit për Zyrtarët Publik, deklaroj me përgjegjësi  
të plotë se nga data: \_\_\_\_\_ kam dhënë dorëheqje dhe jam liruar nga pozita  
\_\_\_\_\_ dhe përmes kësaj deklarate konfirmoj se do të vazhdoj  
tani e tutje të mbaj vetëm pozitën: \_\_\_\_\_.

### Kësaj deklarate i bashkëngjitet ( rumbullako ):

- Deklarata e dorëheqjes nga subjekti politik; ose
- Deklarata e dorëheqjes nga ATK, e deponuar në Divizionin e Burimeve Njerëzore.

Nënshkrimi i nëpunësit civil:

Datë: \_\_\_\_\_